

**AKT – THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR**  
**“A & B. AUDITING”SHPK**



Në bazë të ligjit 7638 datë 19/01/1992 “Për Shoqëritë Tregëtare” dhe të Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin Tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare” krijohet në Fier sot më 07/03/2002 nga shtetësia: zni. Arjeta Cumani e bija e Bajramit dhe e Jenisesë, e datëlindjes 1961, lindur dhe banues në qytetin e Fierit, lagja “29 Nëntori” Rruga “Dervish Hekali”, e cila gjëzon fuqi madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shoqëria “A & B. AUDITING” me Përgjegjësi të Kufizuar.

**HYRJE**

Neni 1

Në kuptim të këtij ligji akti themelimi është kriimi i Shoqërise “A & B. AUDITING” nga ortaku i vetëm znj. Arjeta Cumani.

Neni 2

Ortaku i vetëm merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga sipërmarrja e emërtuar “A & B. AUDITING”.

Qëllimi i këtij Akti është Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “A & B. AUDITING”.

Në mbështetje të dispozitave të mësipërme, aktiviteti i Shoqërisë zhvillohet në mbështetje të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi të cilat janë bazë për rregullimin e misionit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar si profesionist i pavarur .

**O B J E K T I**

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërise do të jetë në fushën e shërbimeve si:

- Kryerjen e kontrollit ligjor të llogarive, dhe ekspertizave kontabel të parashikuara në ligjin “ Për shoqëritë tregtare”ose në ndonjë ligj tjeter të veçantë, për shoqëritë e ndryshme publike dhe private si shoqerite tregetare, institucionet financiare, të kreditit (Bankat), fondacionet dhe organizatat jo qeveritare etj.të cilat i detyron ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë.
- Shoqëria mund të krye si veprimtari dytësore çdo mision tjeter dytësor brenda fushës së profesionit që paraqitet në pajtueshmëri me objektin e saj si:
  - Misione kontraktuale të kontrollit të llogarive.
  - Misione për transformime bashkimi apo ndarje të shoqërive
  - Misione vlerësimi ekspertiza ligjore dhe ekspertiza të tjera të këruara duke përjashtuar ato operacione apo veprimtari që do të shkaktonin papajtushmëri me karakterin plotësisht të përcaktuar profesional.

## AFATI I VEPRITARISE

Neni 4

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “A & B. AUDITING” do të ushtroje veprimtarine e saj në periudhe 10 vjeçare nga koha e regjistrimit si person juridik.

Neni 5

Ky Akt- Themeli është efektive nga dita e rregjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar nga momenti i rregjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe rregjistrimit në Listën e Publikuar të Ekspertëve Kontabël të Autorizar për ushtrimin aktivitetit profesional nga I. E. K.A

## KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali bazë i themelimit të Shoqërise “A & B. AUDITING” është 100 000 lekë, i përbër nga 10 pjesë me vlerë nominale 1000 lekë, e cila është investuar e gjithe nga ortaku i vetëm dhe konfirmohet se ky fond i shprehur në lekë ka ardhur nga shlyeria e pjeseve te kapitalit që është depozituar në Banken Kursimeve Fier me Nr e Llogarisë 03/0266536 fakt që vërtetohet me dokumentin e lëshuar nga kjo Bankë.

Shoqëria ka drejtë të zotërojë pjesëmarrje financiare në shoqëri të tjera të ekspertëve kontabël por pa i berë këto pjesëmarrje objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

Shoqëria është e hapur për pjesëmarrje financiare të shoqërive të tjera të ekspertëve kontabël të autorizuar, duke mos devijuar nga objekti i saj i veprimtarisë.

Neni 7

Ortaku i vetëm është përgjegjës për të gjitha detyrimet në ushtrimin e aktivitetit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj dispozite. Shoqëria përgjigjet për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themeltar.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 8

Administrator i vetëm i shoqërise “A & B. AUDITING” është ortaku i vetëm znj.Arjeta Çumani.





Neni 9

Ortaku i vetëm administrator emëron të gjithe personelin administrativ e operativ dhe e shkarkon atë kur ai e shikon të arsyshme konformë ligjeve në fuqi.

#### JURIDIKSIONI

Neni 10

Shoqëria "A & B. AUDITING" rregullon veprimtarine e saj në përputhje me statutin, dispozitat e më sipërme dhe me rregulloren e IEKA-s në lidhje me normat e organizimit të profesionit.

Neni 11

Selia e shoqërise është në adresën : Lagja "28 Nëntori" Rruga "D.Hekali", Fier.

Neni 12

Mos marveshjet me organet shtetërore, personat juridik e fizik zgjidhen nga Gjykata e faktit percaktuar ne ligjin 8116 datë 29.03.1996 "Kodi i Procedures Civile". Ne rastë të prishjes së Shoqërisë ortaku i vetëm përcakton mënyrën e likuidimit të saj dhe emëron një ose me shumë likuidues sipas dispozitave përkatëse të ligjit.


#### THEMELUSI


Arjeta Çumani

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA FIER  
Nr 408 Regj.

#### VERTETIM

Vertëtohet se sot me datë 12/03/2002(Dymijëedy) në zyren e noterisë Fier u paraqit personalisht znj. Arjeta Çumani, për identitetin e të cilës u sigurova nga Pasaporta Nr.0340350, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cila deklaroi se sa më lartë është me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, dhe e nënshkruan para meje noteres dhe unë noteria e vërtetoj atë regullisht sipas ligjit.





**STATUTI  
I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR**

**“A & B. AUDITING”Shpk**

**KREU I**

Neni 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “A & B. AUDITING” Shpk krijohet në bazë të Aktit të Themelimit, datë 07/03/2002 nga ortaku i vetëm zni. Arjeta Cumani dhe ushtron aktivitetin si person juridik i pavarur

Neni 2

Shoqëria e ushtron aktivitetin në bazë të ligjit 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregetare” dhe i nënshtrohet normave ligjore për zotëruar të drejtën e realizimit të objektit të saj.

Neni 3

Shoqëria “A & B. AUDITING” Shpk fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë si dhe rregjistrimit në Listën e Publikueshme të Shoqërive të Eksperteve Kontabël të Autorizuar, të Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar (I.E.K.A.)

**EMRI, JURIDIKSIONI**

Neni 4

Emërtimi i shoqërise është: Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “A & B. AUDITING”Shpk. Të gjitha aktet dhe të gjitha dokumentat që dalin nga shoqëria dhe që kanë si destinacion (ju adresohen) të tretëve, të tilla si fatura, publikime dhe rjoftime të ndryshme përbajnë jo vetëm emërtimin e plotë të shoqërisë, të ndjekur nga shkronjat sh.p.k, por edhe frazën “*shoqeri e ekspertimit kontabel dhe e kontrollit ligor te llogarive*”. Gjithashtu, ato duhet të përbajnë edhe numrin me të cilin shoqëria është regjistruar në Listën e Publikueshme të IEKA-s .

Neni.5

Selia e shoqërisë është në adresën : Lagja “29 Nëntori”, Rruga “Dervish Hekali”, Fier.

Me vendimin e ortakut të vetëm Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj zyrtare, mund të hapë dhe të mbyllë filiale, degë ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë.

Neni.6

Shoqëria do të ketë vulen e saj në formë të rrumbullaktë me emërin përkatës të përmendur ne dispozitat me lartë

## OBJEKTI

Neni 7

Objekti i veprimitarisë së shoqërise do të jetë në fushën e shërbimeve si:

- Kryerjen e kontrollit ligjor të llogarive, dhe ekspertizave kontabel të parashikuara në ligjin “ Për shoqëritë tregtare”ose në ndonjë ligj tjeter të veçantë, për shoqëritë e ndryshme publike dhe private si shoqerite tregetare, institucionet financiare, të kreditit (Bankat), fondacionet dhe organizatat jo qeveritare etj.të cilat i detyron ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë.
- Shoqëria kryen si veprimtari dytësore çdo mision tjeter brenda fushës së profesionit që paraqitet në pajtueshmëri me objektin e saj si:
  - Misione kontraktuale të kontrollit të llogarive.
  - Misione për transformime bashkimi apo ndarje të shoqërive
  - Misione vleresimi ekspertiza ligjore dhe ekspertiza të tjera të kërkuara duke perjashtuar ato operacione apo veprimtari që do te shkaktonin papajtushmeri me karakterin plotesisht të përcaktuar profesional.

## AFATI I VEPRIMTARISE

Neni.8

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**A & B. AUDITING**” do të ushtrojë veprimitarinë e saj në një periudhë 10 vjeçare nga koha e regjistrimit si person juridik.

## KAPITALI I SHOQERISE

Neni 9

Kapitali bazë i themelimit të Shoqërise “**A & B. AUDITING**” është 100 000 lekë, i përbër nga 10 pjesë me vlerë nominale 1000 lekë, e cila është investuar e gjithe nga ortaku i vetëm dhe konfirmohet se ky fond i shprehur në lekë ka ardhur nga shlyerja e pjesëve të kapitalit që është depozituar në Bankën Kursimeve Fier me Nr e Llogarise 03/0266536 fakt që vërtetohet me dokumentin e lëshuar nga kjo Bankë e cila i bashkëngjitet këtij akti.

Shoqëria ka të drejte zotërojë pjesëmarrje financiare në shoqëri të tjera të ekspertëve kontabël por pa i berë këto pjesëmarrje objektin kryesor të veprimitarisë së saj.

Shoqëria është e hapur për pjesmarrje financiare të shoqërive të tjera të eksperteve kontabël të autorizuar, duke mos devijuar nga objekti i saj i veprimitarës.

Neni 10

Ortaku i vetëm është përgjegjës për të gjitha detyrimet në ushtrimin e aktivitetit të përcaktuara në dispozitat e këtij akti. Shoqëria përgjigjet për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themtar.

Neni.11

Pjesët e kapitalit janë të transferushme në rrugë trashgimnie si dhe tek të tretët.

Kapitali themtar i shoqërisë zmadhohet me vendim të ortakut të vetëm, në pajtim me kërkesat e ligjit. Kapitali themtar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyre.

## KREU II

### DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 12

Administrator i vetëm i shoqërisë “A & B. AUDITING” është ortaku i vetëm znj.Arjeta Çumani.

Neni 13

Ortaku i vetëm administrator emëron personelin administrativ e operativ për të drejtuar sipërmarrjen me vendim absolut.

Mardhëniet midis punëmarrësit dhe punëdhënësit rregullohen nga kontrata e punës e lidhur në baza ligjore, Kodi.i Punës si dhe rregullat profesionale të përcaktuara me VKM dhe IEKA.

Neni. 14

Ortaku i vetëm administrator ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e sipërmarjes dhe mban përgjegjësi ligjore për të gjithë aktivitetin. Në marveshjet me të tretët administratori angaxhon shoqërinë në përputhje me objektin e saj dhe shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e administrimit.

Neni. 15

### . PËRGJEGJËSITË E ORTAKUT PROFESIONIST.

Në misionet apo punimet që shoqëria kryen për klientët e vet, ajo përfaqësohet nga ortaku i vetëm profesionist. Ortaku i vetëm mer përsipër në cdo rast përgjegjësinë për kryerjen profesionale të punës. Në kryerjen e punëve në bashkëpunim me shoqëri të tjera te eksperteve kontabël, apo edhe me ekspertë të tjere kontabël të autorizuar, përgjegjësinë për kryerjen e punës e ka eksperti kontabël i autorizuar i shoqërisë që e ka kontraktuar punën. Përgjegjësia e

shoqërisë e lejon që të ekzistojë përgjegjësia personale e ortakut të vetëm profesionist për punët që ky i fundit ka kontraktuar dhe kryen për llogari të shoqërisë. Ortaku profesionist që pushon së qeni i regjistruar në listën e IEKA-s, pushon nga kryerja e cdo veprimtarie profesionale në emër të shoqërisë që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

Neni.16

Ortaku i vetëm administrator ka në kompetencen e tij eskluzive keto të drejta:

- Ortaku i vetëm ushtron të gjitha kompetencat që parashikohen nga legjislacioni shqiptar, akti i themelimit dhe ky statut.
- Të miratoj dhe të ndryshoj statusin e shoqërisë.
- Të vendosi për shpërbërjen e shoqërise kur ajo është në falimentim.
- Të miratoj raportin e administrimit dhe llogarive vjetore si dhe të shlyejne detyrimet financiare ndaj organeve Tatimore dhe të tretëve.
- Të vendosi në shpërndarjen e fitimit dhe të mbulimit të humbjeve.
- Rregullon mardhënet e punësimit brenda shoqërisë
- Për një administrim me të mirë ortaku i vetëm mund të emërojë edhe një administrator tjetër i cili do të jetë vartës të Ortakut të vetëm administrator.

Neni.17

Administratori vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë, në përputhje me objektin e veprimitarës së saj, duke ushtruar të gjitha kompetencat që i njeh ligi, pa cënuar kompetencat që ligji dhe ky statut ja njohin shprehimi shqipërisë.

Kompetencat e administratorit janë:

- Organizimi i veprimitarës së shoqërisë për të plotësuar programin që buron nga objekti i veprimitarës përcaktuar pvr shoqërinë.
- Administrimi i përgjithshëm i shoqërisë.
- Përfaqësimi i shoqërisë në mardhënie me të tretët
- Përfaqësimi i shoqërisv përparrë autoriteteve gjyqesore, te arbitrimi administrative.
- Administrimi i pasurise dhe aktiveve financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuar nga ortaku u vetëm.
- Të lëshojë dokumente zyrtare në emër dhe për llogari të shoqërisë, brenda kompetencave që i njeh ligja.

### **MARDHENIET E PUNESIMIT**

Neni.18

Ortaku i vetëm administrator vendos për personat që do të punësohen në shoqërinë “A & B. AUDITING”shpk Fier.

Punësimi do të behet në përputhje me ligjin 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punes”

Neni 19

Mardhëniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis paleve. Në ketë kontratë përcaktohen qartë kushtet e punës, të shperblimit, të pushimit etj.

Neni 20

Administratori dhe personeli i shoqërisë duhet të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit të shoqërisë.

### KREU III

#### MARDHENIET FINANCIARE Neni.34

*Bilanci* pasqyron mardheniet financiare ekonomike nga data 1 janar deri me 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 21

Baza e bilancit është evidenca kontabël e hatuar konforme ligjit 7636datë 19/01/1993 “ Per kontabilitëtin”. Ne mbyllje te çdo viti financiar administratori harton inventarin e pasurisë të shoqërisë në këtë datë si dhe pasqyrat financiare vjetore (llogaritë vjetore ), të cilat bashkë me raportin vjetor të administrimit i paraqiten për shqyrtim e miratim ortakut të vetëm, brenda datës 31 mars të vitit që pason vitin financiar të mbyllur

Evidenca kontabel mbahet e detajuar per të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat.

Neni.22

Nga fitimet e çdo viti financiar, pasi të jenë zbritur kur është rasti humbjet e mbartura do të hiqen jo më pak se 5% për rezervën e domsoshme deri sa shuma e kësaj rezerve të arrijë një të dhjetën e kapitalit themeltar. Ortaku i vetëm ka të drejtë që nga fitimet e çdo viti financiar të krijojë rezerva të posaçme duke përcaktuar shumën dhe qëllimin e përdorimit të tyre.

Neni.23

Mbyllja e bilancit vjetor shoqërohet me analizën e pasqyrës Humje/Fitim të ushtrimit të cilat deklarohen në organet fiskale dhe përbëjnë karakter sekret të sipermanjës, gjithashtu këtë kushtë e plotësojnë dhe të gjithe treguesit ekonomik financiar të tjere.

### KREU IV

#### TRANSFORMIMI, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

N eni 24.

Transformimi i shoqërisë nga forma një–ortakëshe, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me disa ortakë ose në shoqëri anonime bëhet me vendim të ortakut të vetëm, duke u

pasuar nga ndryshime respektive të statutit, por në asnjë rast nuk mund të ndryshohet objekti i veprimitarisë për të cilin ajo është krijuar.

Neni 25.

Shoqëria prishet ose shpërndahet:

- a) kur përfundon afati kohorë për të cilin shoqëria është themeluar dhe
- b) në rastin kur nuk mund të realizohet objekti i saj.

Neni 26.

Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje me kërkesat e legjisacionit Shqiptar. Ortaku i vetm pvcakton rregullat pvr procedurat e likuidimit dhe emëron personat që do të zbatojnë këto procedura. Në rastin e prishjes së shoqërisë, pasuria e mundëshme që mbetet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të shoqërisë, i mbetet ortakut të vetëm.

Neni 27.

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 28

Mosmarveshjet në mardhënie me organet shtetërore persona fizik juridik, vendas a të huaj, zgjidhen sipas dispozitave ligjore nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 29

Përsa është shprehur në këtë statut i referohet ligjit 7638 datë 19/11/1992 si dhe ligjit 7636 datë 19/01/1993.


Neni.30

Statuti përpilohet në pesë kopie për t'u dorzuar organeve kompétente, ai është shkruar në gjuhën shipe dhe firmoset nga ortaku i vetëm ne çdo faqe që e përbënë këtë akt .

U përpiluasot më datë 07/03/2002ne Fier.

### **OTRTAKU**

**Arjeta Çumani**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA FIER  
Nr 409 Regj.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me datë 18/03/2002(Dymijëedy) në zyren e noterisë Fier u paraqit personalisht znj. Arjeta Çumani, për identitetin e të cilës u sigurova nga Pasaporta Nr.0340350, madhere, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cila deklaroi se sa më lartë është me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, dhe e nënshkruan para meje noteres dhe unë noteria e vërtetoj atë regullisht sipas ligjit.

NOTE  
(FLUTURA ABDIA )

